

UDHËZIM
Nr. 9, datë 25.10.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 14.5.2019 “PËR KRITERET
DHE NIVELIN E VLERËSIMIT, SI DHE DETAJIMI I PIKËSIMIT PËR TË GJITHA
KATEGORITË UJORE NË UJËRAT E BRENDSHME, FORMAT E TJERA TË
PESHKIMIT NË DET PA PËRDORIMIN E MJETEVE LUNDRUESE, DHE
ZHVILLIMIN E AKUAKULTURËS NË SIPËRFAQE PUBLIKE TOKËSORE DHE
UJORE, PËR PROCEDURËN E KONKURRIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 7, të nenit 30, dhe të pikës 3, të nenit 52, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, si dhe pikës 19, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 31.7.2013 “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural,

UDHËZOJ:

1. Në kreun III “Kriteret e konkurrimit dhe të vlerësimit”, të udhëzimit nr. 4, datë 14.5.2019 “Për kriteret dhe nivelin e vlerësimit, si dhe detajimi i pikësimit për të gjitha kategoritë ujore në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det pa përdorimin e mjeteve lundruese, dhe zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike tokësore dhe ujore, për procedurën e konkurrimit publik”, pas pikës 10, shtohet pika 10/1 me këtë përmbajtje:

“Pika 10 e kreut III, nuk zbatohet në rast se paraqitet një konkurrent i vetëm. Ky përjashtim nuk zbatohet në rastin e lagunave bregdetare dhe të akuakulturës”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**
Bledar Çuçi